



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 72, Datë 22.04.2020

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA”
SH.P.K., NR. 286, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
EKEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR. 59, DATË 23.04.2015.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s Nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.03.2020, “Për disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 24.03.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me komunikimin elektronik të datës 24.03.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k..

- Me komunikimin elektronik të datës 24.03.2020, shoqërisë i është dërguar njoftimi i vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. me komunikimin elektronik të datës 10.04.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 25.09.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”, i ndryshuar.
- Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës (me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 432 Prot., datë 13.02.2020, mbërritur në drejtori në datën 20.02.2020). Afati i fundit për të aplikuar për rinovim licence për këtë shoqëri ishte data 23.02.2020.

Aplikimi i shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mungon dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 3, gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.03.2020, “Për disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë” është vendosur :
 - *Pezullimi i zbatimit të nenit 9, pika 2, gërma “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019 si dhe nenit 9 pika 1 gërma d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror” miratuar nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 97, datë 04.07.2017*

- *Subjektet e licencuar gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t'i paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19 vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, gërma “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike....”*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Nr. 286, Seria T15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 59, datë 23.04.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.04.2020.
2. Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, gërma “d” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE- s Nr.109, datë 29.06.2016, i ndryshuar.
3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI